



# MARTESA

## SHËRBES' E VLESIMIT.

Pas Meshës së hyjshme, Prifti qëndron më shëntëroren' dhe atâ që do t' martohen përpara Dyerve të shënta, burri më të diathtë, dhe gruaja më të mëngjër. Vihen dy unaza m' anën e diathtë t' Alltarit, një e artë dhe një e ergjëntë. Prifti shënon krerët e për-të-martuarve dhe u ep nga një qiri të ndezur, temianis, dhe pastaj thotë DIAKU :

Bekô, ô Zot.

PRIFTI me zë të lartë :

E bekuar është Përëndia jonë për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

DIAKU :

Më paqje le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot.

Për paqjen që-lartazi...

Për paqjen e tërë botës...

Për këtë Shtëpi të shëntë...

Për Kryepeshkopin t' onë...

Për shërbëtorin e Perëndisë (aksh), dhe shërbëtorin e Perëndisë (aksh), që po vlesohen me një-

jatërin, dhe për shpëtimin e tyre, le t' i lutemi Zotit.

Që t' u falë fëmijë për vazhdimin e gjindjes, dhe gjithë lypjet për shpëtim, le t' i lutemi Zotit.

Që t' u dërgojë dashuri të plottë, të paqëshme, dhe ndihmë, le t' i lutemi Zotit.

Që t' i bekojë më një-mëndje dhe besë të shigurtë, le t' i lutemi Zotit.

Që t' i ruaj më rrojtje dhe baritje faqe-bardhë, le t' i lutemi Zotit.

Që t' u falë Zoti Perëndia jonë martesë të nderçime dhe shtrat të pacinuar, le t' i lutemi Zotit.

Që të shpëtohem prej ç' do hidhërimi, mërie, reziku, dhe nevoje, le t' i lutemi Zotit.

Përkrah-na, shpëtô-na...

Tërëshëntë , të pacinuarën...

PRIFTI me zë të lartë :

Se ty të ka hie ç' do lavdi, nder, dhe adhurim, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj thotë këtë Urim me zë të math :

URIM.

O Perëndi e ameshuar, që mblodhe të ndarat me bashkim dhe u vure lidhje dashurie të pazgjidhur ; që bekove Isaakne dhe Rebekkën, dhe i rrëfeve trashëgimtarë të zotimit tënt ; Ti bekô dhe këtë shërbë-

torët e tû, duke i udhë-hequr më ç' dô veprë të mirë.

Se ti je Perëndi mëshirëplote dhe njerzidashëse dhe ty të dërgojmë lavdi, Atit, e Birit...

Paqje mi ju të gjithë.

DIAKU :

Krerët tuaja unjjani Zotit.

PRIFTI me zë të lartë :

O Zot, Perëndia jonë, që e parëvlesove Kishën si një virgjërë të kulluar prej paganëve, bekô këtë vlesim, dhe bashkoj-i e ruaj-i këtë shërbëtorët e tû më paqje e më njëmëndje.

Se ty të ka hie ç' do lavdi, nder, e adhurim, Atit...

Pastaj PRIFTI merr unazat, i ep më parë burrit të artën, e i thotë :

Vlesohet shërbëtor' i Perëndisë (aksh), me shërbëtorin e Perëndisë (aksh), më emërin e Atit, e të Birit, e të Shpirtit Shënt. Amen. (Tri herë.)

Dhe i bën kryq me unazën mi krye.

Pastaj i ep gruas unazën e artë e i thotë :

Vlesohet shërbëtor' e Perëndisë (aksh), me shërbëtorin e Perëndisë (aksh), më emërin e Atit, e të Birit e të Shpirtit Shënt. Amen. (Tri herë.)

Pastaj bën kryq me unazën mi krerët e tyre dhe u'a vë nër

gishtërijt' e diathtë. Pastaj Kuntëri u'a këmben unazat. Dhe PRIFTI thotë këtë

## URIM.

Le t' i lutemi Zotit.

O Zot, Perëndia jonë, që udhëtove bashkë me shërbëtorin e Patrikut Abraam, i cili u-dërgua t' i gjejë nuse të-zott Isaak, dhe i zbulove për vlesim Rebekkën që kish vatur për ujë ; Ti bekô vlesimin e shërbëtorëve tënt (aksh e aksk), dhe shiguroj-e fialën që kanë dhënë ; vendos-i më bashkimin e shëntë që është pranë teje ; se ti që në krye të herës krijove mashkull e fëmër, dhe prej anës s' ate gruaja gjyn-tohet me burrin për ndihmë, dhe për ameshim të gjindjes së njerësve.

Ti pra, ô Zot Perëndia jonë, që dërgove të vërtetën mi trashëgimin tënt, dhe zotimin tënt mi shërbëtorët e tû atërit t' anë, dhe nër të zgjedhurit e tû bres pas brezi, hith synë mi shërbëtorin tënt (aksh), dhe shërbëtoren tënde (aksh), dhe pshtet-e vlesimin e tyre më besë, njëmëndje, të vërtetë, dhe dashurî ; se ti, ô Zot, dëftove të ipet vlesim për të gjitha si shigurî. Me unazë i' u-dha pushteti Josefit në Egjyptë ; me unazë u-lavdërua Danieli në Babylonë ; me unazë u-çfaq drejtësi' e Thamarës ; me unazë Ati ynë qiellor u-rrëfye i mëshirëshim për të-Birin ; se tha : « Epini unazë mi dorën e diathtë, dhe therni viçin e ushqyer që të hamë e të dëfrejmë. » Dora jote e diathtë, ô Zot, qëndroj Moisinë më Dett të kuq ; se me fialën tënde të vërtetë u-shiguruan

qiejtë, e u-themelua dheu ; dhe e diathta e shërbëtorëve tënt do t' bekohet me fialën tënde të push-tetshime, dhe me krahun tënt të lartë. Ti pra, ô Zot, bekô dhe tanî këtë unazim me bekim të qiellshëm : dhe Engjëll prej Zoti vaftë përpara tyre tërë ditët e jetës së tyre.

Se ti je që bekon dhe shëntëron të gjitha dhe ty të dërgojmë lavdi, Atit e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj Litani' e Gjerë dhe Përlëshim.

### SHËRBES' E KURORËZIMIT.

PRIFTI temianis e thotë këtë Psalm :

Lum gjith' atâ që i kanë frikë Perëndisë.

VALLEJA më ç' do vark thotë :

Lavdî ty, ô Perëndia jonë, lavdî më ty.

Atâ që baresin më udhët e tij.

Do të hash pemët e mundimeve tënde.

Lum ti, dhe fat-bardhë do të jesh.

Jote-shoqe do të jetë si vreshtë e ndehur më pllajet e shtëpisë s' ate.

Bijt' e tû si degë ullinjsh të rishmbiellur, rreth tryesës s' ate.

Ja kështû do t' bekohet njeriu që i ka frikë Zotit.

Kështû do t' të bekoje Zoti prej Sionës, dhe do të shohësh të mirat e Jerusalemit gjithë ditët e jetës s' ate.

Dhe do t' shëkosh bijt' e bijve tënt, dhe paqje mi Israelë.

DIAKU thotë :

Bekô, ô Zot.

PRIFTI :

E bekuar është Mbretëri' e Atit...

DIAKU :

Më paqje le t' i lutemi Zotit.

Për paqjen që lartazi...

Për paqjen e tërë botës...

Për këtë Shtëpî të shëntë...

Për Kryepeshkopin tonë...

Për shërbëtorët e Perëndisë (aksh e aksh), që po lidhen me njërijetë me shokëri martese, dhe për shpëtimin e tyre, le t' i lutemi Zotit.

Që të bekohet kiô martesë, si e Kanasë në Galilë, le t' i lutemi Zotit.

Që t' u falë urtësi dhe fëmijë për të mirën e tyre, le t' i lutemi Zotit.

Që të ngazëllohen, duke parë bij e bija, le t' i lutemi Zotit.

Që t' u dhurojë dëfrim mirfëmijësimi, dhe siellje të pabiashmuar, le t' i lutemi Zotit.

Që t' u dhuroje këtyre dhe neve gjithë lypjet për shpëtim, le t' i lutemi Zotit.

Që t' i shpëtojë këtë dhe ne prej ç' d'ô hidhërimi, mërie...

Përkrah-na, shpëtô-na...

Tërëshëntën, të pacinuarën...

PRIFFI me zë të lartë :

Se ty të ka hie ç' do lavdî, nder, e adhurim,  
Atit, e...

DIAKU

Le t' i lutemi Zotit.

PRIFTI thotë me zë të math këtë

URIM.

O Perëndi e kulluar, dhe krijetar i tërë ndërtesës, që shpërftyrove ien e stërgjyshit Adam më grua nga njerzidashja jote, dhe i bekove duke thënë : «Shtohuni dhe shumohuni, dhe zotëroni mi dhenë», dhe i rrëfeve që të dy një trup me martesën ; se përanda j njeriu do të lërë më-nj'-anë t' anë e t' emën dhe do të ngjitet pas gruas së tij, dhe do të jenë që të dy një mish ; dhe atâ që i gjyntoj Perëndia, njeri të mos i ndajë ; që bekove shërbëtorin tënt Abraam, dhe çele gjin' e Sarrës, dhe e bëre atë shumicë kombesh ; që i fale Rebekkën Isaakut, dhe bekove fëmijën e saj ; që bashkove Jakobin me Raqelën, dhe prej syresh çfaqë dymbëdhjetë Patrikët ; që shoqërove Josefin me Asynethen, dhe u fale pemë fëmijësimi Efraimnë dhe Manasinë ; që akseptove Faharinë dhe Elisabetën dhe u dhurove Parërendësin ; që prej rënjës së Jeseut mishërisht burbuqose

Gjithmon-vingjërën, dhe prej saj more trup dhe linde për shpëtim të gjindjes së njerësve ; që nga dhurata jote e patreguar dhe nga mirësia e shumë erdhe në Kanâ të Galilesë, dhe bekovë dasmën e atieshme, që të rrëfesh se martesë e ligjëshmë është dëshira jote si dhe fëmijë-lindja prej saj ; Ti, ô Zot i tërëshëntë, prit dhe faljen tonë të lutësve tënt, duke ardhur dhe këtë si atjê me përmindodhjen tënde të padukur ; bekô këtë martesë, dhe dhuroj' u shërbëtorëve tënt (aksh e aksh) jetë të paqëshme, ditë të gjata, urtësî, dashurî për njërtatërin më lidhjen e paqjes, farë jetë-gjatë, mirënjohjen e fëmijës që është kurorë lavdie e pafishkur ; vlerësoj-i të shëkojnë bij bijsh ; ruaj'u shtratin të palakmuar ; dhe ep'u vesën e qiellit që lartazi dhe të majmët e dheut ; rrafshoj-i shtëpit' e tyre me grurë, verë, vaj, dhe ç' do mirësî që t' u apin dhe atyre që kanë nevojë, duke u dhuruar dhe atyre që janë bashkë me ne gjithë lypjet për shpëtim.

Se ti je Perëndi mëshire, përdëllimesh, dhe njerzidashjeje, dhe ty të dërgojmë lavdî bashkë me Atin tënt pa-nisje, dhe Shpirtin tënt tërëshënt, të mirë dhe jetëdhënës, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit.

PRIFTI thotë me zë të lartë këtë

URIM.

I bekuar je, ô Zot Perëndia jonë, meshëtar i



martesës mystike dhe të pacinuar, ligjëvënës i trupësisë, ruajtës i paprishjes, dhe kujdestar i mirë i nevojave të jetës. Ti dhe tanî, ô Zot i Math, që gatove njerinë mëkryezaj, dhe e vure si mbret të kriesës, dhe the : « S' është mirë të jetë vetëm njeriu mbi dhë ; le të bëjmë një ndihmës për të » ; dhe si more një nga iet e tij, gatove gruan, të cilën, kur e pa Adami, tha : « Kiô është ashtë prej eshtërave të mia, dhe mish prej mishit t' im ; kiô do të quhet grua, se u-muar prej burrit të saj ; përanda j do të lërë njeriu më-nj'-anë t' anë e t' emën, dhe do të ngjitet pas gruas së tij, dhe do të jenë të dy një mish ; dhe atâ që i gjyntoj Perëndia, njeri të mos i ndajë » ; Ti pra dhe tanî, ô Zot i Math Perëndia jonë, dërgô hirin tënt qiellor mi kêtâ shërbëtorët e tû (aksh e aksh) dhe bëj-e këtë vashë t' i bindet më të gjitha burrit, dhe këtë shërbëtorin tënt të jetë më krye të së-shoqes, që të jetojnë pas dëshirës s' ate ; bekoj-i, ô Zot Perëndia jonë, si bekove Abraamin dhe Sarrën ; bekoj-i, ô Zot, si bekove Isaaknë dhe Rebekkën ; bekoj-i, ô Zot Perëndia jonë, si bekove Jakobin dhe gjithë Patrikët ; bekoj-i, ô Zot Perëndia jonë, si bekove Josefin dhe Asynethen ; bekoj-i, ô Zot Perëndia jonë, si bekove Moisinë dhe Sepforën ; bekoj-i, ô Zot, si bekove Zaharinë dhe Elisabetën. Ruaj-i, ô Zot Perëndia jonë, si ruajte Noen në arkë ; ruaj-i, ô Zot Perëndia jonë, si ruajte Jonanë në bark të balenës ; ruaj-i, ô Zot Perëndia jonë, si ruajte tre Diemt' e shëntë prej ziarrit, duke

u dërguar vesë prej qiejve, dhe arthtë mi tâ ay gas, që pati Shënt Elen' e lumur, kur gjeti Kryqin e çëmuar. Kujtoj-i, ô Zot Perëndia jonë, si kujtove Enohun, Semin, dhe Elinë : kujtoj-i, ô Zot Perëndia jonë, si kujtove Dyzet Dëshmorët e shëntë, kur u dërgove kurorët prej qiejve ; kujtô, ô Perëndî, dhe prindërit që i rritnë ; se urata prindërs shigurojnë themelî shtëpish. Kujtô, ô Zot Perëndia jonë, shërbëtorët e tâ kumtërit, që u-mblodhë bashkë në këtë gëzim. Kujtô, ô Zot Perëndia jonë, shërbëtorin tënt (aksh) dhe shërbëtoren tënde (aksh), dhe bekoj-i ; ep'u pemë fëmijësh, diem të bukur, ujdî shpirtesh e trupesh ; lartësoj-i si dëllinjat e Libanit, si vreshtë me herdhî të mira ; dhuroj'u farë kalliu, që, duke patur ç' dô miaftësi, të tepërojnë më ç' dô punë të mirë dhe të pëlqyer te ty, e të shëkojnë bijt' e bijve të tyre, si degë ullinjsh të rish-mbiellur, rreth tryesës së tyre ; dhe, si të dalin faqe-bardhë përpara teje, të shkëlqejnë si yj në qiell, më ty Zotin tonë ; se me ty është lavdia, fuqia, nderi, e adhurimi, bashkë me Atin tënt panisje, dhe Shpirtin tënt jetëdhënës, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit.

PRIFTI me zë të lartë :

O Perëndî e shëntë, që gatove njerinë prej pluhëri, dhe prej ies së tij ndërtove gruan, dhe i' a shoqërove për ndihmës, se ashtû i pëlqeu madhësh-

tisë s' ate, që të mos jetë njeriu vetëm mi dhë; Ti dhe taní, ô Zot i Math, ndeh dorën tënde prej shtëpisë s' ate së shëntë, dhe shoqëroj-i shërbëtorin tënt (aksh) dhe shërbëtoren tënde (aksh), se prej teje shoqërohet gruaja me burrin. Bashkoj-i më njëmëndje; kurorëzohet më një trup; fal'u fëmijë dhe gëzim mirlindjeje: Se jotja është fuqia, dhe jotja është mbretëria, dhe forca, e lavdia, e Atit, e Birit, dhe e Shpirtit Shënt; taní e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pasandaj merr Kurorët dhe më parë kurorëzon Dhëndërin, duke thënë:

Kurorëzohet shërbëtor' i Perëndise (aksh), me shërbëtoren e Perëndisë (aksh), më emërin e Atit, e të Birit, e të Shpirtit Shënt. Passi e thotë tri herë, duke bërë shënjën e Kryqit, kurorëzon Nusën, duke thënë:

Kurorëzohet shërbëtor'e Perëndise (aksh) me shërbëtorin e Perëndisë (aksh) më emërin e Atit, e të Birit, e të Shpirtit Shënt. (Tri herë.)

Pastaj i bekon, duke thënë për-së-treti:

O Zot, Perëndia jonë, kurorëzohet më nder e me lavdë.

#### APOSTULLI.

U vure mi krye kurorë prej gurësh të çëmuar. Jetë të lypnë e u dhe.

*Këndimi prej Letrës së Palit nër Efesianët:*

Vëllezër, përhironi nga herë për të gjitha Perën-

dinë dhe Atin, më emërin e Zotit tonë Jesu Krisht, duke u-bindur njërratërit me frikë Perëndie. Ju gra, binduni në burrat tuaj, si dhe Zotit, se burri është kreu i gruas, sikundër dhe Krishti është kreu i Kishës; dhe ai është shpëtimtar i trupit. Po, siç i bindet Kisha Krishtit, ashtu dhe gratë t' u binden burrave më ç' do send. Ju burra, duajini gratë tuaja, si Krishti dashuroj Kishën, dhe e përdha veten për të mirën e saj, që t' a shëntëroje, duke e paqësuar me banjën e ujit në fialë; që t' i' a dhuroje vetes së tij Kishën të lavdëruar, pa piklë, e pa sufrë, ose t' atillë gjë, po që të jetë e shëntë dhe e kulluar. Ashtu detyrojnë burrat të duan grat' e tyre, si trupet e tyre. Ai që dō të shoqen, dō veten e tij; se asnjë nuk mërziti mishin e tij; po e ushqen dhe e përkujdes, si dhe Krishti Kishën; se ne jemi copra të trupit të tij, prej mishit të tij dhe prej eshtërave të tij. Përandaj do të lerë njeriu t' anë e t' emën, e do të ngjitet pas gruas së tij, dhe do të jenë që të dy një mish. Ky Myster është i math; po flas pas Krishtit e pas Kishës. Po dhe ju cilido veçan ashtu le t' a dojë të shoqen si veten e tij, dhe gruaja të i' a ketë frikën burrit.

Alleluia. Tri herë).

#### UNGJILLI PAS JOANIT

M' atë kohë, u-bë një dasmë në Kanâ të Galilesë dhe ish dhe e Em' e Jesujt atjê. U-ftua dhe Jesuj dhe Nxënësit e tij më dasmën. Dhe kur u-mbarua

vera, i tha Jesujt e Ema : Nukë kanë verë. I thote Jesuj : Ç' ka në mes teje e meje, ô grua ? nukë ka ardhur êdhe ora ime. U thot' e Em' e tij shërbëtorëve : Ç' të ju thotë, bëni. Dhe ishin atjê gjashtë shtëmba prej guri, që ndodheshin pas paqësimit të Judejve, dhe që nxinin dy a tri masa. U thotë atyre Jesuj : Mbushni shtëmbat me ujë; dhe i mbushnë gjer sipër. Dhe u thotë : Nxirni tanî, e shpieri kryesofrësit, dhe i shpunë. Dhe kur e ngjëroj kryesofrësi ujën që ish bërë verë, (dhe nukë dinte ngaha, po shërbëtorët që nxuarë ujën dinin) thërret dhëndërin e i thotë : Ç' dô njeri më parë vë verën e mirë, dhe kur të dehen, atëhere vë të poshtërën; po ti ke mbajtur verën e mirë gjer tanî. Këtë nisje të shënjave bëri Jesuj në Kanâ të Galilesë, dhe çfaqti lavdin' e tij; dhe e besuan Nxënësit e tij.

DIAKU :

Le të thomi me gjithë shpirt...

O Zot i Tërëfuqishim.....

Mëshirô-na, ô Perëndî.....

Të lutemi dhe për mëshirë.....

Dhe kujton kumtërit.

PRIFTI me zë të lartë :

Se ti je Perëndî mëshirëplote dhe njerzidashëse,  
dhe ty të dërgojmë lavdî.....

DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit.

Dhe PRIFTI thotë këtë

URIM

O Zot Perëndia jonë, që dignove me kujdesin tënt shpëtimtar t' a njohësh martesën të nderçime në Kanâ të Galilesë me ndodhjen tënde; ti dhe tanî ruaj-i më paqje e më njëmëndje shërbëtorët e tû (aksh e aksh) që i vlerësove të shoqërohen me njerjatërin. Rrëfej-a' u martesën të nderçime; ruaj-e shtratit e tyre të pacinuar; dignô të mbetet rrojtja e tyre e përbashkme faqe-bardhë; dhe vlerësoj-i t' arrijnë më pleqërî të lashtë, duke punuar urdhëratat e tua me zëmër të bardhë. Se ti je Perëndia jonë, Perëndî mëshire dhe shpëtimi, dhe ty të dërgojmë lavdî, bashkë me Atin tënt pa-nisje,....

DIAKU :

Përkrah-na, shpëtô-na.....  
 Ditën të tërë të mbarë...  
 Engjëll paqjeje.....  
 Ndiesë dhe falje....  
 Të mirat e të dobishimet...  
 Që të shkojmë kohën....  
 Bashkimin e fesë....

PRIFTI me zë të lartë :

Dhe vlerësô-na, ô Zot i Math, që të guxojmë të përthërresim ty Perëndinë qiellore si Atë sheshit e pa-dënim e të thomi :

POPULLI :

Ati ynë që je ndë qiell.....

PRIFTI me zë të lartë :

Se jotja është Mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdia,  
e Atit.....

Paqje mi ju të gjithë...

DIAKU :

Krerët tona le t' i' a unjim Zotit.

Pastaj sillet Qelq'i përbashkmë dhe PRIFTI e bekon duke  
thënë këtë Urim :

Le t' i lutemi Zotit.

O Perëndi, që i bërë të gjitha me fuqinë tënde,  
dhe shigurove gjithësinë, dhe stolise kurorën e gjithë  
gjërave që ke bërë, bekô me bekim të shpirtësh  
dhe këtë Qelq të përbashkmë që u fal këtyre  
që u-bashkuan më shokëri martese.

Se emëri yt është i bekuar dhe e lavdëruar është  
Mbretëri' e Atit.....

Pastaj Prifti merr më dorë Qelqin e përbashkmë dhe u ep  
për-së-treti më parë burrit dhe pastaj gruas. Pastaj Prifti i merr  
e i kthen rreth përçark, bashkë me Kuntërin, i cili mban kuro-  
rët që-prapazi.

Dhe PRIFTI a POPULLI këndojnë këtë Trophe :

TINGËLL TERTHOR I.

Luaj valle, ô Esaja, Virgjërseha mbeti më barrë,

dhe lindi një bir Emmanuel, Perëndi edhe njeri ;  
Lindje është emër' i tij ; të cilin duke madhështuar,  
Virgjëreshën lumërojmë.

## TINGËLL II.

Dëshmorë të shëntë, që luftuat mirë dhe u-kuro-  
rëzuat, nërmjetoni te Zoti, të mëshirohen shpirtet  
tona.

Lavdi ty, ô Krisht Perëndi, mburrj' e Apostujve,  
ngazëllim' i Dëshmorëve, lëçitj' e të cilëve ish Trini'  
e bashkëqënurshme.

Pastaj ngrë Kurorët; dhe më të Dhëndërit thotë :

Madhoh-u, ô Dhëndër, si Abraami, dhe bekoh-u  
si Isaaku, dhe shumoh-u si Jakobi, duke baritur më  
paqje, e duke vepëruar me drejtësi urdhërimet e  
Perëndisë.

Dhe më të Nuses thotë :

Dhe ti, ô Nuse, madhoh-u si Sarra, e ngazëlloh-u  
si Rebekka, e shumoh-u si Raqela, duke u-gëzuar  
me burrin tënt, e duke ruajtur kondicjet e ligjës, se  
ashtu deshi mirë Perëndia.

Pastaj DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit.

PRIFTI thotë këtë Urim:

O Perëndi, Perëndia jonë, që erdhe në Kanâ të  
Galilesë dhe bekove dasmën e atieshme, bekô dhe



këtâ shërbëtorët e tû, që u-bashkuan më shokëri martese pas providencës s' ate. Bekô hyrjet e daljet e tyre ; shumoj-e jetën e tyre me të mira ; merr-i Kurorët e tyre lart në Mbretëri tënde, duke i ruajtur faqe-bardhë, të pacinuar e të palakmuar më jetët të jetëve. Amen.

Paqje mi gjithë ju.

DIAKU :

Krerët tona le t' i a unjim Zotit.

PRIFTI thotë këtë Urim :

Ati, Biri, edhe Shpirti Shënt, Trinia e tërëshëntë, e bashkëqënurshme dhe jetëdhënëse, Hynia e njëshmë dhe Mbretëria, ju bekoftë, e ju faltë jetë të gjatë, fëmijë të mirë, përparim jete dhe bese, ju mbushtë me gjithë të mirat e dheut, dhe ju vlerësoftë për gëzimin e të mirave të zotuara ; me nërmjetimet e Hyjlindëses së shëntë dhe të gjithë Shëntorëve. Amen.

Pastaj hyjnë dhe i urojnë ; dhe, si përshëndoshen, bëhet prej PRIFTIT Përlëshimi kështû :

Krishti, Perëndia jonë e vërtetë, që e rrëfeu martesën të' ndershime, duke u-ndodhur në Kanâ, me nërmjetimet e Zonjës Shën-Marî, t' Apostujve të shëntë, të lavdëruar dhe emër-shkëlqyer, të Shën Kostantin dhe Shën-Elenës, Mbretërve të kurorëzuar prej Perëndie dhe një-me-Apostujtë, të Shën

Prokopit, Dëshmorit të Math, e të gjithë Shëntorëve, na mëshiroftë e na shpëtoftë, si i mirë dhe njerzidashës.

### URIME MË ZGJIDHJEN E KURORËVE.

PAS TETË DITSH.

O Zot, Perëndia jonë, që bekove kurorën e motmotit, dhe na dhë lejë t' u vëmë këtô Kurorë më kryen e atyre që u-bashkuan me ligjë martese, dhe u' a fale si një çpagim të urtësisë, nga që u-shoqëruan të kulluar te dasma që u-vû si ligjë prej teje ; Ti dhe më zgjidhjen e këtyre Kurorëve, bekoj-i të martuarit, dhe ruaj-e bashkimin e tyre të papërndarë, që t' a përhirojnë nga herë emërin tënt të tërëshëntë, të Atit....

Paqje mi ju të gjithë.

Krerët tuaja unjiani Zotit.

URIM.

Shërbëtorët e tû, ô Zot, si mbetnë më një mëndje, dhe mbaruan shërbesën e martesës në Kanâ të Galilesë, dhe u-pajtuan më nyjet e saj, Ty të dërgojnë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Dhe bëhet Përlëshimi.